

CIVIKOS është duke kërkuar një: **Zyrtar/e të Projekteve**

A jeni të interesuar të jeni pjesë e implementimit të projekteve dinamike të Platforma CiviKos? Nëse po, aplikoni për pozitën e zyrtarit të projekteve.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- ▶ Së paku diplome Bachelor në shkencë sociale;
- ▶ Së paku tri vite përvojë në projekte në sektorin joqeveritar;
- ▶ Përvojë të dëshmuar në asistimin e koordinimit të projekteve në sektorin joqeveritar ose në organizata ndërkombëtare;
- ▶ Shkathtësi dhe njohuri elementare në hulumtim, monitorim dhe përgatitje të raporteve;
- ▶ Njohuri për punën e shoqërisë civile dhe ambientit të veprimit të sektorit joqeveritar;
- ▶ Aftësi në të folur dhe shkruar në shqip dhe anglisht;
- ▶ Aftësi të mira ndër-personale dhe shkathtësi për të bashkëpunuar me organizatat dhe donatorët;
- ▶ Përparësi është përvoja e dëshmuar në projekte të financuara nga USAID, EU, dhe donatorë ndërkombëtar që operojnë në Kosovë.

Përgjegjësitë kryesore janë:

- ▶ Organizimi dhe zbatimi i planit të punës të projektit në kohë, në përputhje me procedurat dhe kërkesat e donatorëve;
- ▶ Organizimi i planifikimit të duhur, zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të projektit në koordinim me Drejtorin e Projektit;
- ▶ Planifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve të projektit në teren;
- ▶ Hulumtimi dhe monitorimi i punëve të institucioneve të Kosovës sipas nevojës së projekteve;
- ▶ Mbajtja e procesverbaleve dhe asistimi në përpilim e raporteve për donator;

Dokumentet për aplikim:

- ▶ Një CV të kandidatit/es;
- ▶ Një letër motivuese (1 faqe) për përvojën dhe motivin për t'iu bashkuar ekipit të CiviKos.

Dokumentet e kërkuara mund t'i dërgoni deri më 29.10.2021 në email [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net).

Vërejtje: Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të njoftohen. Platforma CiviKos është bashkim vullnetar i organizatave të shoqërisë civile, të përkushtuara për zhvillimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike.